



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:056335

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554469

KPPP.nr.77/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “KPNP “Pro Eng” SH.P.K., me NUI: 810278748, me seli në Gjilan, kundër debitorit DP & Partners” SH.P.K., me NUI: 811302471, me seli në rr. “Enver Maloku” Kompleksi Tregtia Lokali p.n., në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.696/22 të datës 11.11.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 05.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit DP & Partners” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.696/22 i datës 11.11.2022, i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa dhe SHFUQIZOHET.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit t’ia paguaj debitorit shumën prej 416.00 € (katërqind e gjashtëmbëdhjetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “KPNP “Pro Eng” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.696/22 të datës 11.11.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 22-SHV01-002-34 të datës 06.06.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-002-40 të datës 30.06.2022;

Faturës Nr. 22-SHV01-002-53 të datës 30.07.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-002-61 të datës 31.08.2022 dhe Faturës Nr. 22-SHV01-002-33 të datës 30.05.2022, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit shumën prej 73,852.50 €, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtu që përbaruesi t'a inkasoï me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse të përbaruesit privat Kushtrim Musa, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, duke theksuar ndër të tjerash se me kreditorin kanë lidhur kontratë me datë 27.04.2022 për furnizim me lëndë të parë minerare, mirëpo e veçanta e kësaj kontrate konsiston në faktin se kreditori dhe debitori janë pajtuar që për furnizimin që e bëjnë kreditori të debitori me lëndë të parë minerare fillimisht është dashur që të bëjnë barazimin e fletëdërgesave me sasinë e materialeve të dorëzuara, e pas barazimit të lëshohet fatura e cila do të nënshkruhej nga debitori, duke pasur parasysh edhe faktin se në këto fatura do të duhej të ishin në formatin 40% kesh dhe 60% kompensim. Më tutje ka deklaruar se faturat nuk janë të nënshkruara nga debitori e që rrjedhimisht nuk paraqesin dokument të besueshëm dhe të përshtatshëm për përbarim. Në fund ka shtuar se kreditori nuk ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin monetar, sepse kompensimi është kontraktuar me asete të debitorit, e për të cilat kreditori është pajtuar, prandaj rezulton se dokumenti përbarimor nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe se kreditori nuk ka pasur të drejtë të kërkojë përbarimin. I ka propozuar gjykatës që të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumën prej 416.00 €.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 22-SHV01-002-34 e datës 06.06.2022; Fatura Nr. 22-SHV01-002-40 të datës 30.06.2022; Fatura Nr. 22-SHV01-002-53 e datës 30.07.2022; Faturës Nr. 22-SHV01-002-61 e datës 31.08.2022 dhe Fatura Nr. 22-SHV01-002-33 e datës 30.05.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Faturën Nr. 22-SHV01-002-34 të datës 06.06.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-002-40 të datës 30.06.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-002-53 të datës 30.07.2022; Faturën Nr. 22-SHV01-002-61 të datës 31.08.2022 dhe Faturën Nr. 22-SHV01-002-33 të datës 30.05.2022, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se të njëjtat janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”* .

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret urdhri përmbartimor P.nr.696/22 i datës 11.11.2022, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbartimit, ngase propozimi për përmbartim bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin.

Megjithatë në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim, ndërsa organi përmbartues - përmbartuesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbartimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të debitorit për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 416.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.77/23, datë 05.04.2024

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.